



Komuna e Klinës  
Kryetari i Komunës  
05/2020  
Klinë, dt.16.03.2020

*Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020, lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim të parandalimit nga infeksioni i Corona Virus COVID-19, si dhe vendimin nr.01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, me akordimin edhe të grupit për gatishmëri emergjente të datës 16.03.2020, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 16.03.2020, merr;*

## V E N D I M

1. **OBLIGOHET**, KRU "HIDRODRINI" më seli në Peje, njësia në Klinë, që urgjentisht të krijoj një burim të ujit të Pijshëm që del drejt nga fabrika, më qëllim që qytetaret në këtë kohe emergjente të kenë mundësin e furnizimit.
2. Me rastin e krijimit të mundësinë nga ana e KRU "HIDRODRINI" obligohen të gjithë të i përmbahen radhës dhe distancës më rastin e furnizimit.
3. Vendimi i është i plotfuqishëm dhe do të zbatohet menjëherë.
4. Zbatimi i këtij vendimi behet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

### Te njoftohet:

- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente;
- KRU "Hidrodrini"
- Grupi për gatishmëri emergjente;
- Publiku.

Kryetari,  
Zenun Elezaj